

VENDIM
Nr. 254, datë 5.5.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 872, DATË 11.11.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR
VITIN 2021, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME
UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasqyra nr.1, bashkëlidhur vendimit nr. 872, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me pasqyrën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)**

Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2021

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2021 (lekë)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	31,638,500
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	5,508,420
3	Shërbime e furniturë	14,087,630
4	Investime	685,000
	TOTALI	51,919,550